



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më . ____ .04.2023

Lënda: Përgjigje kërkesës së paraqitur nga CNA Media
Adresa: Adresa: Selitë e Vjetër, Zona Kadastrale 8270 **Tiranë**
E-mail : info@cna.al

Të nderuar,

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, nr. 670 prot datë 04.04.2023 (tonën) dërguar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti) me anë të së cilës në referencë të pikës 1.1 të nenit 20 të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar dhe nenit 11 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kërkohet vënia në dispozicion e dosjeve për 5 (pesë) shtetas shqiptar, konkretisht:

1. Z. L.B.- kryetar i këshillit drejtues të RTSH-së
2. Z. Sh.N.-gazetar, opinionist
3. Z. F.C.- gazetar, opinionist
4. Z. F.L. – gazetar opinionist
5. Z. P.M.- drejtor i Bibliotekës Kombëtare, ju informojmë se :

Së pari : ligji nr 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, gjen zbatim dhe mbetet i apikueshëm ku është e mundur dhe nuk bie ndesh me ligjin organik, pra lidhur me aktivitetin dhe dokumentacionin e prodhuar nga autoriteti publik, informacionet mbi përbërjen, aktet me të cilat rregullohet organizimi dhe funksionimi i veprimtarisë së këtij autoriteti publik.

Objekti i kërkesës për informacion i nënshtrohet pjesërisht ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” për informacionin që në kuptim të pikës 2 të nenit 2 të ligjit nr 119/2014 “Për të drejtën e informimit” konsiderohet informacion publik.

Për këtë informacion Autoriteti, në zbatim të plotë të legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit, mbështetur në parimin e transparencës dhe aksesit në informacion, në mënyrë të vazhdueshme publikon në faqen e tij zyrtare ëeb (lutem referohuni në link-un: <http://autoritetidosjeve.gov.al/>) ekstrakte të vendimeve që merr për shtetasit në cilësinë e kërkuesit.

Me Vendimin nr. 84, datë 11.02.2021 ka informuar kërkuesin L.B. se - nga kërkimet e deritanishme, nuk ekzistojnë të dhëna që shtetasi L.B., të ketë qenë bashkëpunëtor apo i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit.

Për pjesën tjetër të kërkesës vlerësojmë se pavarësisht se kërkohet informacion në cilësinë e qytetarit të zakonshëm në bazë të nenit 20 pika 1.1., kërkesa në cilësinë e kërkuesit media dhe për qëllime të medias CNA, i nënshtrohet dhe rregullohet nga dispozitat procedurale të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar, për mënyrën se si të aksesohet informacioni, sipas dispozitave njohëse dhe kufizuese të ligjit nr. 45/2015 përkatësisht nenit 36-38 të tij.

Sa më sipër ligji nr. 45/2015 i ndryshuar, parashikon në nenin 38 “**Informimi i medias**” të drejtën e përfaqësuesve të medias për të konsultuar të dhënat e Sigurimit ku përcaktohet:

“1. Vënia në dispozicion dhe përdorimi i dokumenteve nga media kryhet në përputhje me nenet 36 dhe 37 të këtij ligji.

2. Kur publikimi i të dhënave personale, të siguruara sipas këtij ligji, shoqërohet me deklaratat të kundërta të personave të përmendur, këto deklaratat u bashkëlidhen të dhënave personale dhe ruhen, vihen në dispozicion e lejohet të publikohen, në të ardhmen, vetëm së bashku me deklaratat kundërshtuese”.

Bazuar në dispozitën e mësipërme të ligjit nr. 45/2015 lidhur me procedurën për shqyrtimin e dokumenteve, vënien në dispozicion dhe përdorimin e dokumenteve nga media, nevojitet të plotësoni formularin përkatës për studiues, media i miratuar nga Autoriteti me qëllim adresimin e kërkesës tuaj, në dispozitën e përcaktuar nga ligji e më pas vijimin e trajtimit të kërkesës. Kjo qasje do të garantohet në kushte që sigurojnë respektimin e të drejtave të njeriut dhe privatësinë e individëve të përmendur në dosje. Bashkëlidhur gjeni formularin dhe Udhëzuesin për studiues/media të miratuara nga Autoriteti.

Kordinatori i të drejtës për informim pranë Autoritetit

L. Cocoli

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Suela Prençi